



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI
KRYETARI**

Nr. ____prot.

Tiranë, më 14.02.2019

VENDIM

Nr. __, datë 14.02.2019

**PËR MIRATIMIN E DORËHEQJES SË ANËTARES SË KËSHILLIT TË
EMËRIMEVE NË DREJTËSI, ZONJËS FATJONA MEMÇAJ, NGA PJESËMARRJA
NË VEPRIMTARITË DHE MBLEDHJET E KËTIJ KËSHILLI PËR
PËRGATITJEN, DISKUTIMIN DHE MIRATIMIN E PROJEKTVENDIMEVE
NORMATIVE TË PARASHIKUARA NGA NENI 228 PIKA 3, NENI 229 PIKA 2 DHE
240 PIKA 6 TË LIGJIT NR. 115/2016**

Në datën 14.02.2019, me nr. Protokollin nr. 18, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, është depozituar shkresa e dërguar po në këtë datë nga anëtarja e Këshillit, zonja Fatjona Memçaj.

Me anë të kësaj shkrese, të drejtuar Kryetarit të Këshillit, bazuar në nenet 222-224 të ligjit nr. 115/2016, nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të nenit 14 pika 1 dhe 2 të Rregullores së Brendshme të KED, anëtarja Fatjona Memçaj informon se, ka vlerësuar që gjendet në kushtet e pengesës ligjore dhe të papajtueshmërisë për të marrë pjesë në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e projektvendimeve të KED lidhur me rregullat e hollësishme normative nënligjore mbi shortin, verifikimin, si edhe vlerësimin, renditjen dhe pikëzimin e kandidatëve për pozicionet vakante.

Njëkohësisht, bazuar në nenin 224 pika 2 të ligjit nr. 115/2016, anëtarja Fatjona Memçaj i kërkon Kryetarit të Këshillit të procedojë dhe disponojë sipas ligjit për miratimin e dorëheqjes dhe mospërfshirjen e saj në përgatitjen dhe procedurat e miratimit të akteve nënligjore të sipërcituara.

Në themel të motivimit të shkresës dhe kërkesës për të proceduar me akt, për miratimin e dorëheqjes dhe mospërfshirjen e saj në veprimtaritë konkrete të sipërcituara të KED, anëtarja Fatjona Memçaj, parashtron rrethanën se, me njëren nga kandidatet për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, zonjën Ardita Alsula (Buna) është në marrëdhënie të posaçme, meqenëse kjo kandidatë është motra e bashkëshortit të saj.

Bashkëlidhur shkresës së datës 14.02.2019, gjendet edhe Certifikata Familjare përkatëse, lëshuar rregullisht nga Zyra e Gjendjes Civile e Njesisë Administrative nr. 7 Tiranë, në të cilën pasqyrohet se kandidatja e lartpërmendur, zonja Ardita Alsula, është motra e zotit Dashamir Alsula, bashkëshorti i anëtares së KED, zonjës Fatjona Memçaj.

Në lidhje me këto rrethana konkrete të parashtruara nga anëtarja e Këshillit, zonja Fatjona Memçaj, në cilësinë e Kryetarit të KED vlerësoj se janë të zbatueshme rregullat e përcaktuara posaçërisht në ligjin nr. 115/2016, i cili, në nenin 223, parashikon se:

“ Neni 223 Papajtueshmëria

Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk mund të marrë pjesë në verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kriterëve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, në qoftë se midis tij dhe kandidatit ekzistojnë marrëdhëniet e mëposhtme:

- a) marrëdhënie martesore ose bashkëjetese;*
- b) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave; ose*
- c) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër dhe njerë. “.*

Gjithashtu, në bazë e për zbatim të këtij Ligji, edhe në Rregulloren e Brendshme të KED, në pikën 1 të nenit 14, parashikohet se:

“ Neni 14 Procedura në rast papajtueshmërie dhe konflikti të interesit

1. Anëtari i Këshillit ose anëtari zëvendësues, nëse ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, nuk merr pjesë në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit të lidhura me çështje që kanë për objekt përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e rregullave normative të shortit, verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, si edhe në procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve për pozicionet vakante.”.

Nga ana tjetër, Ligji nr. 115/2016 dhe Rregullorja e Brendshme e KED kanë përcaktuar edhe mënyrën e procedimit në rastet kur evidentohet gjendja e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose pengesave ligjore së anëtarit të KED në raport me çështjet konkrete që ky Këshill është duke shqyrtuar ose programon të shqyrtojë në mbledhjet dhe veprimtaritë që janë në kompetencën e këtij Këshilli.

Kështu, në pikën 2 të nenit 224 të ligjit nr. 115/2016 parashikohet se :

“ Neni 224 Heqja dorë

2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep Kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari. “.

Në bazë e për zbatim të këtij Ligji, edhe në Rregulloren e Brendshme të KED, në pikën 2 të nenit 14, parashikohet se:

“2. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara që trajtohen në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit, anëtari i Këshillit ose anëtari zëvendësues vjen në dijeni të rrethanave të tilla që, sipas ligjit, e vendosin atë vetë ose një anëtar tjetër, përpara njërit prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, njofton menjëherë Kryetarin e Këshillit dhe deklaron arsyet konkrete që sjellin pengesë për pjesëmarrjen në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e çështjes përkatëse.”

Nga urdhërimet dhe interpretimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, përbën kompetencë dhe detyrim për Kryetarin e Këshillit që, menjëherë, kur vjen në dijeni, të procedojë me shqyrtimin e rastit dhe të vlerësojë, sipas ligjit, ekzistencën e motiveve konkrete ligjore, të cilat janë të zbatueshme në rrethanat konkrete të konstatuara kryesisht, të parashtruara nga vetë anëtari i KED apo nga të tretë, mbi gjendjen e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo pengesës ligjore të anëtarit të KED me përmbushjen prej saj/tij të detyrave dhe kompetencave në KED për shqyrtimin e çështjeve të caktuara.

Në cilësinë e Kryetarit të Këshillit, duke pasur parasysh motivet ligjore dhe rrethanat konkrete të parashtruara nga anëtarja e KED zonja Fatjona Memçaj në shkresën e datës 14.02.2019 dhe në aktin zyrtar të lëshuar rregullisht nga zyra e gjendjes civile, si edhe natyrën e çështjeve që janë për shqyrtim në mbledhjen e KED të datës 15.02.2019 për diskutimin dhe miratimin e aktit normativ për procedurat e shortit, pasi vlerësova këto fakte me ligjin e zbatueshëm të sipërcituar, kam ardhur në përfundimin se anëtarja e KED, zonja Fatjona Memçaj, me të drejtë informon dhe parashtron se gjendet objektivisht në kushtet e papajtueshmërisë të parashikuar nga shkronja “c” e nenit 223 të ligjit nr. 115/2016, duke qenë në marrëdhënie të posaçme, si kunata e njëres prej kandidatëve për pozicionet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Nga njëra anë, vlerësoj se, rregullimet ligjore mbi rastet e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore të përcaktuara në nenet 222-224 të ligjit nr. 115/2016, nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative dhe në ligjin nr. 9367/2005, mund të gjejnë zbatim edhe në rastet kur funksionari publik ka detyrime dhe kompetenca për të marrë pjesë në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e projektakteve normative, kjo për aq kohë sa, në pamundësi të zgjidhjeve të tjera të zëvendësimit të tij apo shtyrjes në kohë të shqyrtimit të projektaktit, mospjesëmarrja e tij nuk pengon funksionalitetin dhe nuk bllokoi përmbushjes e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të organit kolegjal që duhet të procedojë dhe vendosë me diskutimin dhe miratimin e projektaktit normativ.

Nga ana tjetër, në rrethanat konkrete kur, për shkaqe të pavarura nga veprimtaria e KED 2019 dhe sjellja e anëtarëve të tij, këto rregulla normative nuk janë miratuar nga KED paraardhës dhe përpara shpalljes së pozicioneve vakante, kandidimeve dhe ardhjes së tyre për shqyrtim në KED, si edhe për aq kohë sa KED nuk pengohet dhe bllokohet që të ushtrojë detyrimet dhe funksionet e tij të pazëvendësueshme kushtetuese e ligjore, në cilësinë e Kryetarit të KED vlerësoj se është ende rasti që të shmanget pjesëmarrja në cilësinë e anëtares së KED, të zonjës Fatjona Memçaj, në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin prej këtij Këshilli të rregullave normative të procedurave të shortit për caktimin e relatorëve të pozicioneve vakante.

Gjithashtu, në cilësinë e Kryetarit të KED, vlerësoj se është rasti për të pranuar si të motivuar ligjërisht edhe qëndrimin e anëtares së KED Fatjona Memçaj se, është në të njëjtën gjendje papajtueshmërie edhe lidhur me çështjet që janë programuar të pasojnë veprimtarinë

dhe rendin e ditës së mbledhjeve të KED për përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative mbi procedurat e detajuara të verifikimit të kandidaturave, si edhe për procedurat e detajuara të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave. Për rrjedhojë, për të njëjtat motive dhe rrethana, vlerësoj se është rasti që të shmanget pjesëmarrja e anëtares së KED, zonjës Fatjona Memçaj, në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin prej këtij Këshilli të këtyre akteve normative.

Në përfundim të parashtrimeve të mësipërme, duke ushtruar kompetencën që më është ngarkuar nga pika 2 e nenit 224 të ligjit nr. 115/2016, në cilësinë e Kryetarit të KED, vlerësoj se duhet të pranohet dorëheqja e anëtares së KED Fatjona Memçaj nga pjesëmarrja e saj në veprimtaritë dhe mbledhjet e KED për përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative për procedurat e shortit, të verifikimit dhe të vlerësimit e të renditjes së kandidatëve të parashikuara nga neni 228 pika 3, neni 229 pika 2 dhe 240 pika 6 të ligjit nr. 115/2016.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 224 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”,

VENDOSA:

Pranimin e dorëheqjes së anëtares së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, zonjës Fatjona Memçaj, nga pjesëmarrja në veprimtaritë dhe mbledhjet e këtij Këshilli për përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e projektvendimeve normative për procedurat e shortit për caktimin e relatorit, për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të kandidatëve, si edhe për rregullat më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve dhe për rregullat e detajuara të kriterëve dhe për të përcaktuar peshën specifike të tyre në renditjen e kandidatëve, të parashikuara nga neni 228 pika 3, neni 229 pika 2 dhe 240 pika 6 të ligjit nr. 115/2016.

KRYETARI

Ardian Dvorani